




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
**Komiteti për Politikë dhe financa**  
**Nr.01-060/01-26991/22 datë: 20.09.2022**



Npi – 01/296 datë: 23.09.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 23.09.2022 nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

**I MBLEDHJES SË -VI- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**  
E mbajtur më datën: 23.09.2022 (e premte) në ora 09:00 h. në sallën e Kuvendit

Në mbledhje kan marrë pjesë, Kryesuesi: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj znj.Saniye Sadiki, (znj.Heroina Selmani, online). Përvç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar, znj.Kimete Ukaj ZKF, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, znj.Anita Kurti, zyrtare për Informim dhe z.Shqiprim Hyseni, praktikant. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndetë të gjithë të pranishnit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29.08.2022,
2. Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve nga ZKF,
3. Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025, (pas diskutimit publik),
4. Propozim – Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/60 për zgjedhjen e KKSB,

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z.Përparim Ramusa;** Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

**Pika 1**

**Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29.08.2022**

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë. Në vazhdim konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KPF-së, të mbajtur më 29.08.2022.**

## Pika 2

### Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve nga ZKF

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha Bujar Feratit.

**z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar;** Përshëndetje, meqenëse materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar unë nuk do ta zgjati shumë. Por do ta prezantojë raportin në pika kryesore (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

Në mbledhje erdhë edhe z.Lumni Amrushi në ora 09.29h, Kuorumi tani është, 6 anëtarë prezent në mbledhje.

**z.Përparim Ramusa;** Faleminderit për raportin, e dëgjova me vëmendje. Komiteti për adresimin e të gjeturave qenka formuar prej 5 anëtarëve, disa të gjetura qenkan përfunduar e disa janë në proces. Ju inkurajojë që ta merrni seriozisht dhe ti përmirësoni rekomandimet e Auditorit. Unë mendojë se nuk ka nevojë më shumë për debat.

## Pika 3

### Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025, (pas diskutimit publik)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha Bujar Feratit.

**z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar;** Faleminderit, po ja filloj me diskutiimet publike meqenëse prezantimin e planit buxhetor e kemi bërë në mbledhjen e kaluar në Kuvend, ku Kuvendi ka marrë vendim që planin buxhetor ta nxjerrë në diskutim publik. Ne i kemi mbajtur disa takime me qytetarë, me subjektet politike dhe me grupet e interesit. Për të gjitha këto i kemi procesverbalet. Buxheti i planifikuar për vitin 2023 është shuma prej 8.756.04 euro. Më tutje ZKF-ja i prezantoi shumat sipas kategorive ekonomike, ku të gjitha janë të prezantuara në Dokumentin e Planit Buxhetor për vitin 2023 (shih dokumentin). Nëse ka pyetje do të përgjigjem.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Kadri Emini;** Përshëndetje, dy qështje janë parësore në krahasim me vitin paraprakë; E para është se kemi rritje të buxhetit këtë vit mbi 1 milion euro. Dhe e dyta se te projektet po e shoh që ka rritje rrëth 100%. Është mirë që janë marrë parasysh kërkosat e qytetarëve, mirëpo shqetësues është numri i vogël i pjesëmarrjes të qytetarëve në debatin publik. Ndarja e buxheti është bërë në proporcione të njëjtë në secilin fshat. Nëse përpara është investuar më pak tanë unë kërkojë që të bëhet më shumë në investimet kapitale.

**znj.Adelina Beqaj;** Përshëndetje, ti z.Emini tha që janë përfshirë të gjitha fshatrat në buxhet, e që unë mendojë se nuk janë përfshirë sepse kemi fshatrat malore ku nuk janë përfshirë e që janë të rëndësishme për turizmin vendorë, siç janë fshatrat Topillë, Dugë, Karaqicë etj.

**z.Përparim Ramusa;** Është e vërtetë që ka rritje të buxhetit, por unë nuk pajtohem që investimet me shkuar në mënyrë proporcionale, sepse nevojat e vendbanimeve janë të ndryshme.

E falënderoj drejtorin z.Grejtalb Emini që ka treguar angazhim në procesin e debatit publik. Qytetarët edhe më herët nuk kanë marrë pjesë në debate publike. Kamë një pyetje për DPUKGJ-në për sa i përket QKMF-së, i kemi mbi 300 mijë euro pse nuk janë parapa mjete përvitet në vazhdim dhe pse nuk keni filluar me ndërtimin e objektit, dmth pse nuk keni parapa buxhet për 2023?

**z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar;** Pajtohem edhe unë që debatet publike nuk po prodhojnë efekte. Nëse nuk kemi në debate publike, njerëz që i ngritin çështjet ne nuk e dimë saktësisht për nevojat e tyre. Mirë është me qenë më të organizuara OJQ-të në debate publike për buxhet.

**znj.Adelina Beqaj;** Nuk po pajtohem me Bujarin për debatet publike sepse nuk mundemi me i arsyetuar mos prezencën në debate për sa i përket planifikimit buxhetor. Vetëvendosjen e kanë votuar qytetarët që i kanë dhënë 110 premtime. Nuk është arsyesh që mos prezencia e qytetarëve në debate publike.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Përshëndetje, faleminderit për pyetje ne kemi mbajtur debate publike për buxhetin edhe në fshatra, dhe ka pas pjesëmarrës dhe kemi marrë disa

kërkesa të tyre. Disa prej kërkesave të tyre edhe janë marrë parasysh. Ideja është që QKMF-në me e ndërtuar me donacione e jo me pare të Komunës. Tani për tani jemi duke punuar në sigurimin e lokacionit si dhe projektimin e saj. Te pyetja e Adelinës kur tha se nuk ka investime në fshatrat malore, p.sh fshati Duga dhe Karaqica janë përfshirë në një kodë të përbashkët. Po ashtu edhe fahati Rancë është përfshirë. Ne duhet me bërë një planë të veprimit për Agroturizmin, e tek pastaj me filluar me investimet, e jo me mbet investimet shkretë.

**z.Përparim Ramusa;** Nëse nuk filloni menjëherë me ndërtuar QKMF-në keni me arrit në pikën që mos me i fut në qarkullim 85 mijë euro, dhe atëherë këto mjete ka me ti marrë Qeveria.  
**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Për gjendjen që sot jemi, ndodhë që në mbledhjen e Kuvendit ta kemi projektin. Për pjesën e financimit unë besojë se për ne ato mjete financiare nuk do të humbin si investim.

**z.Lumni Amrushi;** Përvendetje, desha me repliku me drejtorin, sepse unë kamë bërë pyetje për fshatin Pjetërshticë për sa i përket disa projekteve, pse juve po ju dështojnë disa projekte dhe pse nuk po bëni presion për me filluar realizimi projekteve, a mos po bëni diferencim në fshatin Pjetërshticë, drejtori e dinë për cilat projekte e kamë fjalën.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Dha sqarime për pyetjen e Lumni Amrushit, Kryesuesi, **z.Adnan Ademi;** Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezant.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi që t’i rekomandoi Kuvendit miratimin e Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025.**

#### Pika 4

Propozim – Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/60 për zgjedhjen e KKSB Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.


**z.Përparim Ramusa;** Nuk kemi çka diskutojmë shumë sepse u sqarua, kështu që unë jam që ta votojmë këtë ndryshim. Desha me thënë që te votimi i juaj “Për” sa i përket pikës të Planit Buxhetor, ka me qenë në kundërshtim me votën e juaj sepse drejtori tha se ka me ndryshuar. **Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ne e bëjmë rekomandimin mbi bazën e këtij dokumenti të buxhetit, ndërsa nëse ka ndryshime atëherë ekzekutivi do ti prezanton në mbledhjen e Kuvendit, dhe Kuvendi është ai që do të vendosë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezant.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/60 për zgjedhjen e KKSB.**

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 10:13h.

Procesmbajtësi  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF  
Adnan Ademi